



DOKUMENT POLITIKASH

Bileta të subvencionuara për studentët



IMPRESSUM

©2024 Forumi për Ndryshime në Arsim; Форум за образовни промени (Forum for Educational Change), European Endowment for Democracy (EED)

Publisher / Издавач / Publikues: FNA - Forumi për Ndryshime në Arsim / FECH - Forum for Educational Change / ФОРП - Форум за образовани промени

Rreth autorëve:

Edina Elezi
Hana Emrullahu
Fjolla Dalipi
Sofia Randoncic
Nenad Dimchevski

Redaktor: Blendi Hodai

Përkthyes / Преведувачка:
Behare Kasami

Ky dokument u përgatit me mbështetjen e **Forumit për Ndryshime në Arsim** dhe Blendi Hodait, Drejtor Ekzekutiv në Forumin për Ndryshime në Arsim (FECH) si pjesë e programit **CreActive Academy** të financuar nga European Endowment for Democracy. Përgjegjësia për pikëpamjet e paraqitura në këtë punim bien mbi autorin(ët). Ai nuk pasqyron domosdoshmërisht politikën apo pozicionin zyrtar të European Endowment for Democracy.

1. Përmbledhje

Rritja e shpenzimeve të transportit ndërkomunal me autobus në Maqedoninë e Veriut ka krijuar barriera të konsiderueshme për të rinjtë, veçanërisht studentët dhe profesionistët e në fazë të hershme të karrierës. Kjo çështje është veçanërisht akute në qendrat kryesore akademike si **Tetova, Shkupi, Shtipi dhe Manastiri**, ku studentët shpesh udhëtojnë çdo ditë për ligjërata universitare. Mesatarisht, këta studentë shpenzojnë **400 - 500 denarë në ditë** për transport, që paraqet një barrë të konsiderueshme financiare që ndikon në vijimin e mësimit dhe i ngarkon buxhetet familjare. Në vitin akademik **2023/2024** në Republikën e Maqedonisë së Veriut kishte **52.316 studentë të regjistruar**. Prej tyre, universiteti më i madh, **Universiteti Shën Kirili dhe Metodi në Shkup (UKIM)**, ka përafërsisht **25,700 studentë**, me **11,812 studentë** që vijnë nga jashtë Shkupit dhe që kërkojnë mundësi transporti të besueshme dhe të përbalueshme për të ndjekur mësimet. Kjo ngarkesë financiare ndikon në pjesëmarrjen akademike dhe zgjeron hendekun midis të rinjve të zonave urbane dhe rurale, duke kufizuar qasjen e barabartë në arsim, punësim dhe mundësitë e angazhimit kulturor.

Për të adresuar këtë, ne propozojmë inkuadrimin e Biletave të subvencionuara për studentët aktivë universitarë. Kjo iniciativë do të ofrojë dy mundësi të përbalueshme udhëtimi, duke siguruar qasje të barabartë në arsim, duke nxitur rritjen e lëvizshmërisë dhe angazhimin e studentëve nëpër qytete. Iniciativa për subvencionimin e transportit do të funksionojë nën një **Partneritet Publiko-Privat (PPP)** midis qeverisë dhe operatorëve privatë të autobusëve, duke u mundësuar studentëve të udhëtojnë në çdo drejtim në të gjithë vendin me tarifa të subvencionuara.

Duke e bërë udhëtimin ndërkomunal më të përbalueshëm dhe më të qasshëm, Biletat e subvencionuara për studentët synojnë të mbështesë zhvillimin socio-ekonomik të të rinjve të Maqedonisë së Veriut, veçanërisht të studentëve aktivë universitarë, dhe të nxisë një të ardhme më të barabartë.

Ky propozim është frymëzuar nga **programi i mobilitetit të të rinjve në Slloveni**¹, ku një model i ngjashëm ka demonstruar me sukses fuqinë transformuese e të bërit të transportit më të qasshëm dhe më të përbalueshëm për të rinjtë. Ky program mobiliteti është miratuar në legjislacionin slloven nën **Ligjin për Transport Rrugor (ZPCP-2)**.

2. Zgjidhja e propozuar

Nisma **për subvencionimin e transportit të studentëve** është krijuar për të lehtësuar barrën financiare të transportit ndër-urban apo ndër-komunal për **studentët aktivë universitarë** në Maqedoninë e Veriut. Ky grup i synuar përfaqëson të rinjtë që studiojnë në qytete të ndryshme nga vendbanimi i tyre i përhershëm dhe kërkojnë mundësi të

1

<https://www.studentska-org.si/studentski-kazipot/prevoz/subvencioniran-prevoz/#:~:text=Kdo%20so%20upravi%C4%8Denci%3Fse%20je%20pred%20dopolnjenim%2022>



përballueshme të besueshme udhëtimi dhe për të ndjekur mësimet, për të marrë pjesë në aktivitete akademike dhe për t'u angazhuar në angazhime të lidhura me universitetin. Programi do të sigurojë që këta studentë të përfitojnë nga shpenzimet e parashikueshme dhe të përballueshme të udhëtimit, duke u mundësuar atyre të fokusohen në arsimimin e tyre pa sforcimet e shpenzimeve të tepërta të udhëtimit.

Kjo nismë do të ofrojë **dy opsione të përballueshme të biletave** të përshtatura për të përmbushur nevojat e studentëve për udhëtime:

1. **Bileta 10-Udhëtime në muaj:** Me çmim prej **1,100 MKD (18 €)**, e krijuar për studentët që udhëtojnë më rrallë.
2. **Biletë e pakufizuar mujore:** Me çmim prej **2,150 MKD (35 €)**, ideale për studentët që udhëtojnë çdo ditë ose bëjnë udhëtime të shpeshta ndër-urbane.

Përshtatshmëria e Biletave të subvencionuara për student është e kufizuar për **studentët e rregullt universitarë** të regjistruar në institucione të akredituara të arsimit të lartë, të cilët mund të ofrojnë dëshmi të regjistrimit (që janë student të rregullt) dhe që banojnë në një komunë të ndryshme nga universiteti i tyre.

Nisma do të zbatohet përmes një **Partneritetit Publiko-Privat (PPP)** ndërmjet qeverisë dhe kompanive private të autobusëve. Qeveria do të subvencionojë diferencën midis tarifës fikse të studentëve dhe shpenzimeve të transportit, duke siguruar që operatorët e autobusëve të mbeten financiarisht të qëndrueshëm. Programi do t'ju mundësojë studentëve të udhëtojnë nëpër çdo rutë autobusi ndër-urbane në mbarë vendin, pavarësisht nga operatori, duke nxitur lëvizshmëri pa pengesa.

Duke integruar **kartelat fizike** dhe **biletat dixhitale** (që do të jenë kompatible edhe me Apple Wallet dhe Google Pay), do të siguron qasje dhe komoditet për studentët. Përveç kësaj, studentët do të jenë në gjendje të rinovojnë biletat e tyre çdo muaj në stacionet e autobusëve ose nëpërmjet një platforme në internet, duke e bërë sistemin të përshtatshëm për përdoruesit dhe të adaptueshëm për nevojat individuale.

Kjo nismë u jep prioritet nevojave të studentëve, ndërkohë që hedh bazat për zgjerim afatgjatë në demografi të tjera të të rinjve, pasi burimet financiare shtesë të bëhen të disponueshme.

Tabela e dhënë më poshtë tregon **çmimet aktuale të transportit ndër-komunal** për linja të ndryshme në Maqedoninë e Veriut. Këto shpenzime transporti përfaqësojnë një **implikim të rëndësishëm financiar** për studentët, shumë prej të cilëve duhet të udhëtojnë çdo ditë midis vendbanimit të tyre dhe universitetit.

Linja	Çmimi aktual (Një drejtim)	Biletë mujore
Tetovë – Shkup	200 denarë	5500 denarë
Gostivar- Shkup	350 denarë	6000 denarë
Gostivar – Tetovë	120 denarë	2500 denarë
Kumanovë – Shkup	170 denarë	5000 denarë
Kërçovë – Shkup	500 denarë	5500 denarë
Manastir – Prilep/ Resnjë	200 denarë	/
Manastir – Shkup	600 denarë	16000 denarë

Shpenzimet e transportit si këto, veçanërisht për udhëtarët e përditshëm, paraqesin një barrë të rëndë mbi buxhetet e studentëve, duke reduktuar qasjen dhe mundësinë e përballimit të arsimit të lartë. Shumë studentë, veçanërisht ata nga zonat rurale ose familjet me të ardhura të ulëta, janë në rrezik të reduktimit të pjesëmarrjes në jetën akademike për shkak të pengesave financiare të shpenzimeve të udhëtimit.

Ne besojmë fuqimisht se **të rinjtë janë studentë vetëm një herë** në jetën e tyre dhe është thelbësore që ata të mbështeten nga qeveria, universitetet dhe institucionet gjatë kësaj periudhe formuese. Një mbështetje e tillë mund të marrë formën e **transportit të subvencionuar** ose **bursave**, duke siguruar që studentët të mos kufizohen nga barrierat financiare dhe të mund të thellohen plotësisht në arsimimin dhe përvojën e tyre studentore.

3. Funkcionaliteti i programës së Subvencionimit të transportit studentor

Biletat e Subvencionuara për Studentët do të jenë të disponueshme për studentët e rregullt universitarë të regjistruar në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut, të cilët studiojnë në një qytet të ndryshëm nga vendbanimi i tyre i përhershëm. Ky kriter i përshtatshmërisë siguron që programi mbështet në mënyrë specifike studentët që udhëtojnë për arsimimin e tyre dhe kërkojnë mundësi të përballueshme transporti ndër-urban.

Për të aplikuar, studentët duhet të vizitojnë sportelin më të afërt të stacionit të autobusëve. Ata duhet të sigurojnë një indeksin dhe një letër **vërtetim për studentë të rregullt** të lëshuar nga universiteti i tyre, duke verifikuar statusin e tyre aktiv të regjistrimit. Përveç

kësaj, studentëve u kërkohet të plotësojnë një formular bazë aplikimi me detajet e tyre të kontaktit, duke përfshirë emrin, numrin e telefonit dhe adresën e emailit, për të finalizuar procesin e aplikimit.

Pasi dokumentet e dorëzuara të verifikohen nga stafi në sportelin e stacionit të autobusëve, studentët mund të zgjedhin të marrin biletën e tyre në një nga dy formatet: një kartelë fizike ose një biletë dixhitale. Bileta dixhitale mund të integrohet lehtësisht në **Apple Wallet** ose **Google Pay**, duke ofruar një opsion të përshtatshëm për përdoruesit e aftë për teknologji, të cilët preferojnë të menaxhojnë biletën e tyre në mënyrë dixhitale.

Me marrjen e kartelës së tyre fizike ose të biletës dixhitale, studentët mund të aktivizojnë opsionin e tyre të zgjedhur të udhëtimit - qoftë **Biletën me 10 Udhëtime** ose **Biletën e pakufizuar mujore** - duke paguar tarifën e kërkuar për muajin. Ky aktivizim mundëson qasje të menjëhershme në udhëtime ndër-urbane të përballeshme dhe pa probleme në të gjitha rrugët pjesëmarrëse.

4. Plani i zbatimit

Hapi	Përshkrimi	Afati kohor	Institucioni
1	Nënshkrimi i marrëveshjeve zyrtare ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) dhe kompanive të autobusëve për të marrë pjesë në programin për Transport të Subvencionuar Studentor. Kjo do të përfshijë përvijimin e planit të subvencionimit dhe kushteve të bashkëpunimit, dhe krijimin e kornizës për një partneritet publik-privat (PPP) për të siguruar qëndrueshmërinë e programit. Në mënyrë të veçantë ata do të përcaktojnë modelet e çmimeve, mekanizmat e rimbursimit dhe pranimin universal të këtij modeli për të gjithë operatorët.	Prill 2025	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (MTL), Kompanitë e Autobusëve
2	Sigurimi i miratimit për iniciativën në Qeveri dhe ndarja e buxhetit të nevojshëm për subvencionet e transportit. Ky hap do të përfshijë bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës , Qeverisë dhe Ministrisë së	maj - qershor 2025	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (MTL), Kompanitë e Autobusëve dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës

	Transportit për të finalizuar angazhimet financiare dhe integrimin e nismës në buxhetin e shtetit;		
3	Finalizimi i procesin e dizajnit dhe lëshimit të kartelave fizike dhe biletave dixhitale (kompatibile me Apple Wallet dhe Google Pay). Trajnim i stafit të kompanive të autobusëve për procedurat e verifikimit për e biletave të subvencionuara.	Qershor 2025	MTPT, Kompanitë e Autobusëve; Trupi Kombëtar Studentor dhe Kuvendet Studentore Universitare
4	Zbatimi i programit në rrugët kyçe me trafik të lartë studentor (p.sh. Tetovë-Shkup, Kumanovë-Shkup, Manastir-Shtip) për të testuar funksionalitetin, për të mbledhur komente dhe për të vlerësuar efektivitetin e programit.	Shtator - Dhjetor 2025	MTPT, Kompanitë Pjesëmarrëse të Autobusëve, Autoritetet Lokale të Transportit
5	Bazuar në rezultatet pilot, rafinim i sistemit dhe lëshimin e iniciativës në të gjithë vendin, deri në semestrin e verës duke siguruar qasje të barabartë për studentët në të gjitha komunat.	janar 2026	MTPT, Kompanitë Pjesëmarrëse të Autobusëve, Autoritetet Lokale të Transportit
6	Monitorimi dhe evaluimi	I vazhdueshëm	

5. Përfundim

Zbatimi i **Transportit të Subvencionuar Studentor** paraqet një investim strategjik për të rinjtë e Maqedonisë së Veriut, që synon përmirësimin e qasjes në arsim dhe zbutjen e barrës financiare të transportit ndër-urban për studentët e universitetit. Duke ofruar zbritje të tarifave, respektivisht harxhimeve të shportës studentore. Programi jo vetëm që trajton sfidat e menjëhershme financiare me të cilat përballen studentët, por gjithashtu mbështet synime më të gjera kombëtare të përfshirjes sociale, zhvillimit ekonomik dhe transportin e qëndrueshëm.

Ky propozim synon të lidhë më mirë qytetet studentore dhe të sigurojë qasje më të lehtë për studentët që studiojnë larg vendbanimit të tyre të përhershëm. Në këtë mënyrë, programi ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për të rinjtë që përballen me sfida financiare dhe logjistike gjatë ndjekjes së studimeve universitare. Zbatimi i Transportit të Subvencionuar Studentor është një investim strategjik që kërkon një mbështetje financiare



vjetore nga Buxheti i Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut prej rreth **9-10 milionë euro**.

Duke ofruar një model të transportit të qëndrueshëm dhe të subvencionuar, kjo nismë ndihmon jo vetëm në zbutjen e sfidave të menjëhershme, por edhe në krijimin e një mjedisi më të pastër dhe më të qëndrueshëm. Në të njëjtën kohë, programi mbështet zhvillimin ekonomik përmes krijimit të një fuqie punëtore më të kualifikuar dhe forcimit të bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe operatorëve privatë të transportit